

Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 21.02 - 29.04.2022, gjithsej **419 kandidatë, (400 meshkuj dhe 19 femra)**, sipas rajoneve përkatëse në tabelën bashkëlidhur.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në **09 dhjetor 2021**.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë dënua nga gjykata për vepra penale.
- Të mos jetë në ndjekje penale.
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata.
- Të ketë figurë të pastër morale.
- Të mos ketë probleme me deportimin.
- Të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin.
- Të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale.
- Mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtarë/detarë aktiv nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përgjatë bëmë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç.
- Të ketë kryer minimumi arsimin 9-vjeçar brenda ose jashtë vendit, të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat.
- Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit.
- Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtarë/detarë aktiv nga Komisioni Mjekësor Ushtarak.
- Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

2. Procedura e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv.

Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura të RSH si ushtarë/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit. Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit, pranimit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, kuotat e rekrutimit, specialitetet, rajonet e rekrutimit, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes, etj.

3. Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në QPR.

3.1 Kandidatët për ushtarë/detarë aktiv paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët në fazën e regjistrimit është:

- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtarë/detarë aktiv, si dhe jo më pak se dy mundësi zgjedhje për njësinë apo repartin në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, (formulari i aplikimit).
- Fotokopjen e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare, 1 copë, e cila gjenerohet online nga QPR-ja në bashkëpunim me DMBNJ&SH, në portalin e-albania, sipas akteve ligjore në fuqi.
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9 x 12 cm.
- Fotokopje të noterizuar të çertifikatës së arsimit 9-vjeçar, ose të diplomës së arsimit të mesëm apo të lartë.
- Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), për drejtim automjeti, për njohje të gjuhës angleze, të noterizuara.
- Raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje infektive dhe të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale të jetës.
- Ekzaminimet mjekësor për agjentët infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë.
- Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimi në Qendrën e Personel Rekrutimit, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit për ushtarë/detarë aktiv, si dhe formularët e vetëdeklarimit.

b) Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit:

Kandidatët fitues, brenda dy javëve duhet të sjellë në QPR dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga prokuroria.
- Vërtetim nga gjykata.
- Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor (KML) i Njësine Mjekësore Ushtarake.

Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësive Fizike:(Aneksi A)

Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra	
Pompa	Pikët	Pompa	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Vrapim 1000 m	Pikët	Vrapim 1000 m	Pikët
58	100	33	100	71	100	65	100	4'05"	100	4'20"	100
57	99	32	98	70	99	64	99	4'06"	99	4'21"	99
56	98	31	96	69	98	63	98	4'07"	98	4'22"	98
55	97	30	94	68	97	62	97	4'08"	97	4'23"	97
54	96	29	92	67	96	61	96	4'09"	96	4'24"	96
53	95	28	90	66	95	60	95	4'10"	95	4'25"	95
52	94	27	88	65	94	59	94	4'11"	94	4'26"	94
51	93	26	86	64	93	58	93	4'12"	93	4'27"	93
50	92	25	84	63	92	57	92	4'13"	92	4'28"	92
49	91	24	82	62	91	56	91	4'14"	91	4'29"	91
48	90	23	80	61	90	55	90	4'15"	90	4'30"	90
47	89	22	78	60	89	54	89	4'16"	89	4'31"	89
46	88	21	76	59	88	53	88	4'17"	88	4'32"	88
45	87	20	74	58	87	52	87	4'18"	87	4'33"	87
44	86	19	72	57	86	51	86	4'19"	86	4'34"	86
43	85	18	70	56	85	50	85	4'20"	85	4'35"	85
42	84	17	68	55	84	49	84	4'21"	84	4'36"	84
41	83	16	66	54	83	48	83	4'22"	83	4'37"	83
40	82	15	64	53	82	47	82	4'23"	82	4'38"	82
39	81	14	62	52	81	46	81	4'24"	81	4'39"	81
38	80	13	60	51	80	45	80	4'25"	80	4'40"	80
37	79			50	79	44	79	4'26"	79	4'41"	79
36	78			49	78	43	78	4'27"	78	4'42"	78
35	77			48	77	42	77	4'28"	77	4'43"	77
34	76			47	76	41	76	4'29"	76	4'44"	76
33	75			46	75	40	75	4'30"	75	4'45"	75
32	74			45	74	39	74	4'31"	74	4'46"	74
31	73			44	73	38	73	4'32"	73	4'47"	73
30	72			43	72	37	72	4'33"	72	4'48"	72
29	71			42	71	36	71	4'34"	71	4'49"	71
28	70			41	70	35	70	4'35"	70	4'50"	70
27	69			40	69	34	69	4'36"	69	4'51"	69
26	68			39	68	33	68	4'37"	68	4'52"	68
25	67			38	67	32	67	4'38"	67	4'53"	67
24	66			37	66	31	66	4'39"	66	4'54"	66
23	65			36	65	30	65	4'40"	65	4'55"	65
22	64			35	64	29	64	4'41"	64	4'56"	64
21	63			34	63	28	63	4'42"	63	4'57"	63
20	62			33	62	27	62	4'43"	62	4'58"	62
19	61			32	61	26	61	4'44"	61	4'59"	61
18	60			31	60	25	60	4'45"	60	5'00"	60

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT